



Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi

Konceptet e përgjithshme të kësaj fushe janë:

1. Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore
2. Proceset shoqërore
3. Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë
4. Vendimmarrja dhe institucionet
5. Mjedisit, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

1. Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore

Në këtë nivel, ky koncept përfshin njohuri të thelluara, për raporte të qëndrueshme në familje, në grup shoqëror, bashkësi dhe shoqëri në aspektin historik, filozofik, sociologjik dhe atë psikologjik.

Në përmbajtjen e këtij koncepti përfshihen edhe njohuritë dhe aftësitë për pjesëmarrjen aktive në strukturat dhe organizimet e ndryshme shoqërore.

2. Proceset shoqërore

Ky koncept përfshin njohuri për zhvillimet, proceset dhe ndryshimet shoqërore dikur dhe sot në rrafshin vendor rajonal, evropian dhe botëror.

Në kuadër të këtij koncepti përfshihen edhe njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet për ndryshimet në strukturën e popullsisë dhe zhvillimin e vendbanimeve, duke përfshirë edhe migrimet, diasporën, diversitetin dhe komunikimin ndërkulturor, ndryshimet në edukim, teknologji dhe globalizim.

3. Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohurit më të thelluara, për normat dhe rregullat shoqërore duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor.

Kjo i mundëson nxënësit të konsolidojë të kuptuarit për to dhe të angazhohet për respektimin e tyre. Koncepti përfshin edhe thellimin dhe zgjerimin e njohurive për liritë dhe të drejtat e njeriut, përgjegjësitë ndaj vetes, familjes, bashkësisë dhe shoqërisë.

Kjo përfshin edhe njohuritë për barazinë gjinore, tolerancën, solidaritetin, përpjekjet kundër diskriminimit, stereotipive dhe paragjykimeve, konfliktet sociale, komunikimi dhe bashkëpunimi me të tjerët, dikur dhe sot.

4. Vendimmarrja dhe institucionet

Ky koncept përfshin njohuri të thelluara për vendimmarrjen dhe institucione. Po kështu, konsolidimin e vetëbesimit të nxënësit për marrjen e vendimeve të arsyeshme në situata konkrete të jetës së përditshme.

Koncepti përfshin edhe njohuritë lidhur me gjykimet dhe vlerësimet për vendimmarrjen e

drejtë, të vetëdijshme, të përgjegjshme dhe të argumentuar.
Koncepti përfshin edhe njohuritë për nivelet dhe llojet e ndryshme të vendimmarrjes, individuale, grupore e institucionale si dhe për rolin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes demokratike në vendimmarrje.

5. Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Koncepti përfshin njohuri të thelluara për raportin e njeriut dhe mjedisit për lidhjet dhe ndikimet

e tyre të ndërsjella, shkaktarët që ndikojnë në dëmtimin e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij.

Koncepti gjithashtu, përfshin njohuritë, vetëdijesimin për angazhimin e ruajtjes së mjedisit, resurseve dhe energjisë, kujdesin për objektet e trashëgimisë kulturore e natyrore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

REZULTATET E TË NXËT TË FUSHËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Shkalla kurrikulare 1

1. Nxënësi/ja mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to:

1. Tregon (rrëfen) për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), rrethin ku jeton e vepron si dhe organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike.

2. dallon disa aspekte të shprehjes së identitetit personal dhe grupor, si: fizik, psikologjik, kulturor, social, administrativ, me qëllim ndërlidhjeje me të tjerët, pavarësisht dallimeve.

2. Nxënësi/ja njihë rëndësinë e monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre:

1. Përshkruan ngjarje shoqërore, kulturore dhe historike si dhe dukuri natyrore e mjedisore përmes shembujve nga jeta e përditshme dhe nga e kaluara.

2. Kupton proceset dhe dukuritë e ndryshme shoqërore dhe natyrore dhe ndërvarësinë e njeriut me natyrën.

3. Nxënësi/ja njihë dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet:

1. Identifikon dhe respekton traditat dhe festat si pasqyrim i llojllojshmërisë kulturore, fetare, shoqërore, etnike e familjare.

2. Merr pjesë në caktimin e rregullave për jetën personale (kohën e punës, argëtimit, vizitave, pushimit dhe gjumit), rregullave të familjes, të shkollës dhe grupeve ku ai është i përfshirë dhe u përmbahet atyre.

4. Nxënësi/ja përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme:

1. demonstroi vetëbesim dhe merr vendime për çështje që lidhen me situata nga jeta e përditshme, në përputhje me moshën si individ dhe si anëtar i një grupi (familja, shkolla, etj.)

5. Nxënësi/ja kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm:

1. Njeh dhe dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm, në rrethin ku jeton dhe kupton rolin që ka në ruajtjen e mjedisit.

2. Kupton ndërlidhjen e mirëqenies personale e shoqërore në raport me kujdesin ndaj mjedisit.

6. Nxënësi/ja shfrytëzon në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe teknologjitë tjera bashkëkohore:

1. Përdor TIK-un dhe median që të pajiset me informacione të përshtatshme për moshën lidhur me shoqërinë dhe mjedisin.

2. ushtron operacione themelore në përdorimin e TIK–ut për nevojat e tij shkollore.

REZULTATET E TË NXËT TË FUSHËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Shkalla kurrikulare 2

1. Nxënësi/ja mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to:

1. Identifikon dhe krahason dëshmi të thjeshta (objekte, mjete, fotografi, veshje dhe gjëra të tjera) që lidhen me ngjarje personale, familjare dhe të komunitetit ku jeton dhe i klasifikon sipas kronologjisë.

2. dallon strukturën e grupeve të ndryshme shoqërore si p.sh.: familja, shkolla, etj., dhe mund të bëjë krahasime si kanë qenë ato dikur dhe si janë tani.

3. Kupton dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të fëmijëve si mënyra më e mirë për mbrojtjen e individëve dhe bashkësisë nga padrejtësitë.

2. Nxënësi/ja njih rëndësinë e monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre:

1. Identifikon ngjarje shoqërore, kulturore e historike të nivelit lokal, vendor, kombëtar e më gjerë dhe shkaqet që sollën ato.

2. Kupton rëndësinë e objekteve, dukurive dhe proceseve shoqërore natyrore e mjedisore në nivel lokal, vendi, regjional dhe botëror.

3. Tregon respekt për trashëgiminë kulturore e natyrore si dhe shpreh solidaritet në proceset shoqërore ku ai është i përfshirë.

3. Nxënësi/ja njih dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet:

1. dallon llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave, besimeve, profesioneve në shoqëri dhe shpreh respekt për këtë diversitet.

2. Tregon ndërgjegjshmëri për dallimet gjinore, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demonstroi tolerancë dhe solidaritet në komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët.

4. Nxënësi/ja përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme:

1. Identifikon dhe shpjegon faktorët që duhet t'i marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve në situata të ndryshme nga jeta e përditshme.

2. Kupton nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucione dhe shoqëri, dikur dhe tani, dhe i respekton ato në veprimet e tij.

5. Nxënësi/ja kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm:

1. Shpjegon disa nga shkaqet dhe pasojat e rreziqeve natyrore e shoqërore si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe veprimeve të njeriut dhe merr pjesë në aktivitete për ruajtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë.

2. Bashkëpunon me të tjerët dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër, kujdeset për përdorim të drejtë të të mirave jetësore për higjienën e përgjithshme dhe për atë personale.

6. Nxënësi/ja shfrytëzon në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe teknologjitë tjera bashkëkohore:

1. Shfrytëzon TIK-un dhe mjetet multimediale për t'i plotësuar dhe thelluar njohjet për ngjarjet

dhe dukuritë kulturore, historike e natyrore.
2. demonstroi shkathtësi në përdorimin e TIKut dhe medias për nevojat e mësimi, prezantimit dhe komunikimit.
3. demonstroi sjellje të përgjegjshme të përdorimit të drejtë të teknologjisë në harmoni me rregullat për ruajtjen e mjedisit.

REZULTATET E TË NXËT TË FUSHËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI
Shkalla kurrikulare 3
1. Njih rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to
1. Njih grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.
2. Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.
3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimin, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.
2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke
1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasqyruar lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.
2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.
3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet
1. Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.
2. Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.
4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme
1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme
2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).
5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm
1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për

ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.
2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.
6. Përdor në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore
1. Përzgjedh dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve digjitale që kanë të bëjnë me raportet shoqërore dhe dukuritë natyrore e mjedisore.
2. Përdor teknologjinë adekuate për moshën për të prezantuar idetë e tij para të tjerëve.

REZULTATET E TË NXËT TË FUSHËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI
Shkalla kurrikulare 4
1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to
1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.
2. Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë).
3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.
2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke
1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.
2. Shpiegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti
3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet
1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme
2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm,
4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme
1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.
2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh

qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.
5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm
1. Prezanton shembuj se si, si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.
6. Përdor në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore
1. Kategorizon dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve mediale për të analizuar ngjarje shoqërore e historike si dhe dukuri gjeografike e mjedisore.
2. Përdor teknologjinë për prezantime të ndryshme që kanë të bëjnë me çështje shoqërore, historike, natyrore e mjedisore.

REZULTATET E TË NXËT TË FUSHËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI
Shkalla kurrikulare 5
1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore, dikur dhe sot, dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to
1. Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, kombëtare e botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike.
2. Krahason zhvillimet e grupeve shoqërore, institucioneve, strukturat dhe mënyrat e organizimit të tyre, dikur dhe tani.
2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre
1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh opinionet personale për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale.
3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet
1. Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin si: traditat, rregullat, besimet, mitet, legjendat, arkitekturën autoktone) monumentet, veshjet, ushqimet, etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global.
2. Analizon dhe vlerëson shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.
4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme
1. Analizon në mënyrë kritike dallimet ndërmjet sistemeve të vendimmarrjes në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëta, si dhe ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve në rrethana dhe në periudha të ndryshme historike.
5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin qëndrueshëm

1. Bazuar në analizën paraprake, identifikon një problem konkret aktual të ndotjes në mjedisin e tij, planifikon punën, mbledh të dhëna, analizon dhe interpreton ato dhe vjen me një sërë zgjidhjesh të qëndrueshme.

6. Shfrytëzon në mënyrë efektive TIK-un dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore

1. Shfrytëzon burime të ndryshme të shkruara dhe elektronike për të bërë analiza (shkak-pasojë) të ngjarjeve të rëndësishme shoqërore në mjedisin ku jeton si dhe në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

REZULTATET E TË NXËT TË FUSHËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Shkalla kurrikulare 5

1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore, dikur dhe sot, dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to

1. Analizon strukturën dhe funksionimin e grupeve shoqërore, dikur dhe tani, dhe nxjerr përfundime për mënyrat e angazhimit në mënyrë konkrete në dobi të interesave të bashkësisë dhe shoqërisë.

2. Merr iniciativë në organizime rinore në shkollë dhe jashtë saj për të zhvilluar proceset demokratike dhe i adreson çështjet me interes përmes veprimeve konkrete.

2. Hulumton objektet/monumentet, dukuritë, proceset historike, shoqërore e mjedisore si dhe lidhshmërinë dhe ndikimet ndërmjet tyre

1. Vlerëson dhe ndërlidh efektet e proceseve shoqërore, historike e mjedisore në jetën e individëve dhe të shoqërisë.

2. Merr pjesë aktivisht (planifikim, organizim, udhëheqje, menaxhim etj.) në aktivitete hulumtuese duke përdorur lloje të ndryshme të informacioneve për ngjarjet dhe dukuritë shoqërore, historike dhe sjell të dhëna të mbështetura në fakte, duke iu shmangur paragjykimëve dhe opinioneve subjektive.

3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet

1. Vlerëson përpjekjet për liritë dhe të drejtat e njeriut, në kontekste dhe periudha të ndryshme kohore dhe angazhohet për respektimin e larushisë shoqërore.

2. Prezanton fakte dhe opinione, sqaron prejardhjen e tyre dhe përmes tyre nxjerr përfundime dhe shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për çështje dhe dukuri të ndryshme shoqërore, historike, kulturore.

4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme

1. Veçon mënyrat e vendimmarrjes në periudha dhe në kontekste të ndryshme shoqërore e historike dhe nxjerr përfundime për rëndësinë e vendimmarrjes së drejt.

2. Vlerëson ndikimin e zhvillimit ekonomik, shkencor dhe teknologjik në shoqëri në përgjithësi si dhe në vendimmarrje.

5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin qëndrueshëm

1. Analizon karakteristikat shoqërore– ekonomike të mjedisit, proceset ekonomike, sociale, politike, kulturore dhe paraqet ndryshimet në shoqëri si rezultat i ndërveprimit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

6. Shfrytëzon në mënyrë efektive TIK-un dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore

1. Përdor me shkathtësi programe dhe mjete digjitale për të qenë qytetar i informuar dhe pjesëmarrës aktiv në veprimtaritë shoqërore dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.